



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.08.2023

**MBLEDHJA Nr. 44,**  
**Datë 23.08.2023, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 23.08.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 44 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 16.08.2023.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (sh.a. KESH)” për kualifikimin e HEC-ve të Kaskadës së Lumit Drin (HEC Vau i Dejës, HEC Koman dhe HEC Fierzë)
3. Mbi licencimin e shoqërisë “ERSEKA SOLAR PARK 2” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW (AC)
4. Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “TEKSOEN 1” me kapacitet të instaluar 2 MW
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “GEALB ENERGY” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Guri i Bardhë 1” me fuqi të instaluar 5360 kW dhe “Guri i Bardhë 2” me fuqi të instaluar 3940 kW, me fuqi totale të instaluar 9300 kW
7. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.08.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë “DERBI-E” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “ANTENA” me fuqi të instaluar 1105 kW
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s 16, datë 23.01.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “DIEZELA” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “LJUSA”, me kapacitet të instaluar 1980 kW, i ndryshuar

## 9. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**  
**ANËTARI I BORDIT**  
**Erjola SADUSHI**